


# Udhëzime për ndërtimin e stallave me sistem të lirë të lopëve të qumështit

*Përmbledhje e një referati në një simpozium të kompanisë “Schaumann” në Sarajevë, në 12 Mars 2013, nga z. Olger Nanogjokaj, drejtor shitjesh dhe konsulent i Austria Praemix Shpk, përfaqësuese ekskluzive e kompanisë Schaumann për Shqipërinë edhe Kosovën*



## **Mirëqenia e lopëve**

*Sa më shumë rritet rendimenti i qumështit, aq më shumë rriten dhe kërkesat e lopëve për kushtet e mbarështimit.*

Organizimi i stallës me shtretërit (kuçetat), hapësirat ku lopët lëvizin, trogu i ushqimit dhe pirëset e ujit, janë komponentët kryesorë, të cilat kontribuojnë në mirëqenien e lopëve. Lista e mëposhtme kërkon nga fermat e qumështit vëmendje të veçantë:

**Shtretërit:** Mundësitë optimale të shtretërve janë: shtretërit gome, apo zgjidhja më praktike dhe më e lirë, një shtresë prej së paku 15 cm trashësi kashtë e thatë ose tallash i hollë. Në bokset e thella të shtruara me kashtë konstatohen gjithmonë dëmtime minimale të lëkurës dhe këmbëve. Nje kriter shumë i rëndësishëm për shtrate komforte të lopëve është gjatësia e bokseve = 1,70 deri në 1,75 m + 0,7 deri në 1 m, duke konsideruar edhe hapësirën për lëvizjen e gjatë ngritjes së lopës nga pozicioni i shtrirë.

**Korridoret:** Korridoret optimale janë të sheshta, të thata dhe jo të rrëshqitshme, ndërsa rritja e brirëve dhe konsumimi i thundrave duhet të jenë gjithmonë në nivele të kontrolluara. Gjerësia ideale është 2,5 cm deri në 3 m. Sipërfaqet duhet të pastrohen nga plehu së paku dy herë në ditë. Gjerësia e çarjeve të dyshemeve me zgara duhet të jetë 3,0cm dhe 3,5 cm dhe sipërfaqja e shkëljes duhet të jetë 8cm - 10 cm, të cilat mundësojnë një pastërti të kënaqshme duke shmangur rrezikun e dëmtimeve të thundrave.

**Grazhdi i ushqimit dhe pirëset e ujit:** Lopët mund të shkojnë në grazhdin e ushqimit 10 herë në ditë dhe cdo herë që shkojnë mund të ushqehen për 30 minuta.

Si rregull për kërkesën për ujë të lopëve vlen: 5 - 6 litra për kg qumësht të prodhuar. Gjatë periudhës së verës kërkesa për ujë të lopëve me rendimet të lartë qumështi është 180 lt ujë/ditë.

Praktike janë vaskat e ujit, të cilat mundësojnë pirje të ujit nga shumë lopë njëkohësisht. Për çdo grup planifikohen mesatarisht 2 pirëse uji, që të shmangët konflikti për vendet. Meqënëse pas mjeljes nevoja e lopëve për ujë është shumë e lartë, duhet të krijohet mundësia e vendosjes së një vaske pirëse në dalje të dhomës së mjeljes.

## **Udhëzime për një silazhim si duhet - Silazhim në momentin e duhur**

Silazhet pranverore, si faktorë kryesorë në ushqimet voluminoze për prodhimin e qumështit, duhet të kenë 30% deri në 40% lëndë të thatë. Si rregull, masa e njomë, që do të silazhohet, duhet të qëndrojë në fushë maksimumi për një ditë, në mënyrë që humbjet e karbohidrateve të foragjerëve të minimizohen. Duke vepruar kështu arrihet një ngjeshje optimal e masës së njomë. Për të realizuar një silazh me vlera të larta ushqyese është i domosdoshëm përdorimi i substancave ndihmëse në

silazhim, p.sh. BONSILAZH, të cilat mbështesin procesin e fermentimit dhe garantojnë kështu një silazh stabil dhe të pasur me energji.

Silazhet me përqindje të larta të lëndës së thatë (LTH) rrezikohen të mos ngjeshen mirë, sidomos atëherë kur gjatësia e masës së njomë të coptuar është më shumë se 4 cm, duke pasur kështu një tendencë mykjeje. Në kushtet e motit të keq silazhimi duhet realizuar brënda ditës.

Kompromisi për një silazh me përqindje të ulët të lëndës së thatë (eventualisht përzierja me kashtë të thatë) është më optimal se sa lënia në fushë e silazhit për një kohë të gjatë dhe si pasojë në humbje të mëdha. Veçanërisht gjatë kosës së dytë dhe të tretë shumë pak fermerë ia arrijnë të kapin kohën optimale të kositjes dhe në fund të fazës së mbylljes së gropës, silazhim me një përqindje të masës së thatë (LTH) prej më shumë se 40%. Mënjanimi i këtyre problemeve arrihet me një mobilizim maksimal të makinerive për transportin nga fusha në gropë dhe për shtypjen e gropës së silazhit.

Në mot të mirë vlen ky rregull: rritja e përqindjes së lëndës së thatë për çdo orë është afërsisht 2%. Në kushte të njëjta tharjeje, kur rritja e masës vegetative nuk është më e lartë (si p.sh. gjatë kosës së tretë), niveli i përqindjes së masës së thatë dyfishohet me 4% për orë.



Një shpërndarje uniforme e masës së njomë për silazhim në gropë me ndihmën e makinerive me peshë të rëndë, sidomos në kosën e parë, bën të mundur një tharje të njëtrajtshme të masës së njomë. Një parcelë foragjesh me një masë të njomë të konsiderueshme dhe përqindje të lëndës së thatë 17%, arrin në mot të mirë në rreth 4 deri 6 orë një përmbajtje të lëndës së thatë prej 30%.

Kështu që, sipërfaqet e kositura dhe të hapura për tharje në mëngjes, duhet të silazhohen po në të njëjtën ditë.

Në kushtet kur rrezikohet tharje shumë e shpejtë e masës për silazhim, duhet të mënjanohet kthimi i masës së njomë. Copëtimi i shkurtër i masës së njomë mundëson ngjeshje dhe fermentim ideal të masës për silazhim. Ngjeshja e mirë e gropës së silazhit realizohet, duke përdorur automjete të rënda, koha e mjaftueshme e ngjeshjes për çdo gropë, si edhe aplikimi i BONSILAZHIT janë të domosdoshme për procesin e fermentimit dhe silazhim të suksesshëm.